



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Ae.nr.284/2019

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, Liridon Maloku dhe Qerim Ademaj, anëtarë në çështjen juridike të paditësit Kompania e Sigurimeve [“K...”] me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit [V.R], Avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve [“E...”], me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit [F.SH], për shkak të rimbursimit të borxhit, në shumën e përgjithshme prej 4,135.95€, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, EK.nr.94/17, të datës 27.06.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.02.2020, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve, [“E...”], me seli në Prishtinë ndërsa **VËRTETOHET** Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, EK.nr.94/17, të datës 27.06.2019.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, EK.nr.94/17, të datës 27.06.2019, në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses Kompania e Sigurimeve [“K...”] me seli në Prishtinë, ku është detyruar e paditura Kompania e Sigurimeve [“E...”], me seli në Prishtinë në emër të regresit paditëses t’ia paguaj shumën prej 4,135.95€, me kamate prej 8% në vit e cila fillon të rrjedh nga data e parashtrimit të kërkesës në procedurën e rregullt të datës 02.07.2017, e deri në pagesën definitive, që të gjitha brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ndërsa në pikën II të dispozitivit e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses Kompania e Sigurimeve [“K...”] me seli në Prishtinë, e paraqitur kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve [“E...”], me seli në Prishtinë, për kompensim nga baza e regresit dhe atë në shumën prej 863.56€. Dhe në pikën III të dispozitivit është detyruar e paditura që palës paditëses t’ia paguaj shumën prej 200.00€, brenda afatit kohor prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi, në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë pala e paditur, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Apelit ta aprovoje ankesën si të bazuar, dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje Ekonomike Ek.nr.94/2017, të datës 27.06.2019 ta ndryshoje dhe të gjykoje shuma me të ulëta.

Përgjigje në ankese ka paraqitur pala paditëse me propozimin që të refuzohet ankesa e të paditurës si e pathemelte dhe të vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë V.EK.nr.94/2017 i datës 27.06.2019.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

#### **Ankesa është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Paditësi, Kompania e Sigurimeve ["K..."], me seli në Prishtinë pranë gjykatës së shkallës së parë, me datë 21.02.2017, ka paraqitur padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve ["E..."] me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të borxhit nga baza e regresit, në vlerë prej 5,042.80€, lidhur me aksidentin e datës 14.11.2015, për çka edhe ka kërkuar nga gjykata që ta aprovojë në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ta detyrojë të paditurën që t ia paguaj shumën e përgjithshme prej 5,042.80€ me kamatë prej 12% në vit nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit në shumën prej 4,135.95€ në emër të regresit, me arsyetim se baza e kërkesëpadisë nuk është kontestuese ndërmjet palëve. Meqë paditësi si sigurues i automjetit të aksidentuar mbi bazën e sigurimit autokasko, ia ka kompensuar të siguruarit dëmet e shkaktuara në lartësia prej 5,042.80€ me të drejtë ka parashtruar kërkesën e rimbursimit të borxhit pranë kompanisë siguruese ["E..."]. Mbi këtë bazë dhe duke u bazuar në nenin 960 par.1 i LMD-së, gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Ndërsa e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit për shumën prej 863.56€, me arsyetimin se nga raporti i ekspertizës së makinerisë të punuar nga z. [N.SH] të datës 06.01.2019 ka rezultuar se dëmi në automjetin "Toyota Avensis" ka qenë në shumën prej 4,135.95€. Prandaj , Gjykata e shkallës së parë duke u mbështetur në dispozitat e nenit 960 par.1, si dhe në dispozitat e nenit 143 par.1 dhe 452.1 të LPK-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar së objekt shqyrtimi i kësaj çështje ishte edhe pretendimi i të paditurës së eksperti i makinerisë e ka pasur si reference faturën me numër ... dhe konstatimit të ekspertit duhet ti zbritet shuma prej 769.24€. Mirëpo pas shqyrtimit të provave të lëndës gjykata ka gjetur së pretendimet e palës së paditur janë të pabazuara, ngase ka konstatuar se raporti i ekspertizës se makinerisë është punuar në mënyrë profesionale dhe se eksperti drejtë ka bërë kalkulimin e çmimit të pjesëve të dëmtuara.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht nenin 960 par.1 të LMD-së, me të cilin është përcaktuar se *“me pagimin e kompensimit nga sigurimi kalojnë në siguruesin, në bazë të vetë ligjit, deri në shumën e kompensimit të paguar, të gjitha të drejtat e të siguruarit ndaj personit i cili mbi cilën bazë qoftë është përgjegjës për dëmi”*, në rastin konkret nga shkresat e lëndës, rezulton se përgjegjës për dëmin e shkaktuar në aksidentin e datës 14.11.2015, ka qenë i siguruari i të paditurës Kompania e Sigurimeve [“E...”] me seli në Prishtinë, me ç ‘rast paditësi ia ka paguar të siguruarit të tij kompensimin e dëmit të pësuar dhe me pagimin e kompensimit të gjitha të drejtat e të siguruarit kanë kaluar të paditës.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e palës së paditur lidhur me gjendjen faktike, lidhur me ate së eksperti i makinerisë e ka pasur si reference faturën me numër ... dhe konstatimit të ekspertit duhet ti zbritet shuma prej 769.24€, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, ndërsa pretendimet e të paditurës janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërthënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK .

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS,**  
**Ae.nr.284/2019, dt.21.02.2020**

**KRYETARI I KOLEGJIT,**  
**Mahir Tutuli, d.v.**

